



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 1, Dt. 21.09.2010

Per shfuqizim te vendimit nr 15 date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin e lumit Shushice subjektit "Spartaku" shpk, ne jug-lindje te fshatit Vodice, komuna Kote, Qarku Vlore.

Ne mbeshtetje te Vendimit Nr.63, Dt. 26.01.2001,"Per procedurat e kerkimit, te shqyrtimit dhe dhenies se autorizimeve, te lejeve dhe koncensioneve, per perdorimin e rezervave ujore", pika 16 e te ciles percakton, afatet brenda te cilave subjekti ka fituar te drejten e perdorimit te nje rezerve ujore duhet te filloj veprimtarine jane: ... Per lejet 12 muaj, pas ketij afati subjekti humbet te drejten e perdorimit te kesaj rezerve ..., si dhe pikes 2 ne kushtet e "Ndryshimit ose anullimit te lejes", sipas se ciles "Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon per to me Agjensine e ujit perkatese, brenda nje afati kohor tre muaj", duke qene perpara faktit qe subjekti "Spartaku" sh.p.k., me administrator Z. Bardhyl Resulaj, nuk e ka konsumuar te drejten per shfrytezimin e shtratit te lumit Shushice, per nxjerrjen e materialeve inerte (zhavorr) brenda nje viti dhe nuk e ka paguar as siperfaqen e dhene ne shfrytezim, duke vete humbur te drejten e perdorimit te kesaj leje, K.B.U "Vjose":

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr 15, date 06.08.2007 te K.B.U "Vjose" dhe anullim te lejes per shfrytezim te materialeve inerte ne shtratin e lumit Shushice subjektit "Spartaku" shpk, me administrator Z. Bardhyl Resulaj, ne jug-lindje te fshatit Vodice, Komuna Kote, Qarku Vlore.
2. Ngarkohet A.U.B "Vjose" Vlore, per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B "VJOSE"

Ardian DINE



KRYETARI I K.B.U "VJOSE"
Hasan HALILI

